

DHOMA E POSAÇME E
GJYKATËS SUPREME TË
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË
LIDHEN ME AGJENCINË
KOSOVARE TË
MIRËBESIMIT

SPECIAL CHAMBER OF THE
SUPREME COURT OF KOSOVO
ON KOSOVO TRUST AGENCY
RELATED MATTERS

POSEBNA KOMORA
VRHOVNOG SUDA
KOSOVA ZA PITANJA
KOJA SE ODNOSE NA
KOSOVSKU
POVERENIČKU AGENCIJU

ASC-10-0047

Në padinë e

[REDACTED],

[REDACTED], Gjilan

përfaqësuar nga [REDACTED],

avokat në Gjilan

Paditësi / Ankuesi

vs

1. NSH [REDACTED],

Gjilan

2. Agjencia Kosovare e Privatizimit,

Prishtinë,

Të Paditurit

Kolegji i Ankesave të Dhomës së Posacme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtarë, në ankesën e Paditësit kundër aktvendimit të Trupit Gjykues të DHPGJS-së të datës 18 maj 2010, SCC-09-0230, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 11 nëntor 2010, lëshon këtë

AKTVENDIM

1. Ankesa hedhet poshtë si e papranueshme.

2. Në rastin e ankesës, pika 2 e aktvendimit të Trupit Gjykues të datës 18 maj 2010, SCC-09-0230, hiqet.

3. Ankuesi obligohet që të paguaj në Dhomën e Posaçme taksat gjyqësore në shumë prej 55,--.

Arsyet ligjore:

Me urdhrin e datës 30 dhjetor 2009, të dërguar tek Paditësi më 16 janar 2010, Trupi Gjykues i DHPGJS-së kërkoi nga Paditësi që të plotësojë padinë e tij të dërguar vetëm në gjuhën shqipe të datës 14 dhjetor 2009 me përkthimin në gjuhën angleze, dhe të rregullojë mangësitë brenda 30 ditëve (parashresa / shtojca e autorizimit ligjor të vlefshëm, dëshminë e njoftimit të 'Agjencinë', 'emrin dhe adresën për dorëzim të të Paditurit [REDACTED]).

Më 19 shkurt 2010, paditësi paraqiti parashtresën duke iu përgjigjur urdhrit.

Me aktvendimin e atakuar të datës 18 maj 2010, Trupi Gjykues i DHPGJS-së e refuzoi padinë si të papranueshme (pika 1), për shkak se Paditësi nuk kishte dorëzuar autorizimin e duhur ligjor, të nënshkruar nga ai, dhe për shkak se nuk kishte ofruar 'emrin dhe adresën e plotë për dorëzim të të Paditurit "[REDACTED]"). Trupi Gjykues më tej tregoi në këtë aktvendim se ankesa (në Kolegjin e Ankesave të DHPGJS-së) mund të ushtrohet brenda 30 ditëve (pika 2).

Aktvendimi iu dërgua Paditësit më 9 qershori 2010.

Në ankesë, të vënë më 9 korrik 2010 në një zarf adresuar Gjykatës Supreme të Kosovës, Paditësi (i përfaqësuar nga avokati [REDACTED]) kërkon revokimin e këtij aktvendimi.

Ankesa duhet të hedhet poshtë si e papranueshme.

Në bazë të nenit 9.5 të RREG UNMIK-ut 2008/4 ndaj aktvendimit të Trupit Gjykues të DHPGJS-së mund të bëhet ankesa në Kolegjin e Ankesave të DHPGJS-së brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit (ASC-09-0096, ASC-10-0012 et al).

Përkundër kësaj dispozite, neni 59.1 i UA UNMIK-ut 2008/6 përcakton se 'ankesa parashtrohet në Dhomën e Posaqme brenda dy muajve prej datës kur i dorëzohet aktgjykimi palës që ankohet'. Megjithatë, neni 9.5 i RREG UNMIK-ut 2008/4 është mbizotëruar pasi që është i standardit më të lartë. Prandaj, mundësia e zbatimit të nenit 59.1 të UA UNMIK-ut 2008/6 është e kufizuar për lëndët që nuk mbulohen nga neni 9.5 i RREG UNMIK-ut 2008/4. Kështu që, zbatohet afati kohor për 30 (tridhjetë) ditësh nga pranimi i aktvendimit.

Neni 20.1 i UA UNMIK-ut 2008/6 parashevë se periudha e përcaktuar me RREG UNMIK-ut 2008/4 ose me UA Ilogaritet si vijon: Kur periudha shprehët me ditë, Ilogaritet nga momenti kur ndodh ngjarja (këtu: dërgimi i aktvendimit), ndërsa dita gjatë së cilës ndodh ngjarja nuk numërohet se bie në periudhën në fjalë (krahaso nenin 112 [1] të Kodit të Procedurës Civile, Gazeta Zyrtare 4/77-1478 et al. të RSFJ-së ["LPK"], që zbaton të njëjtin sistem).

Aktvendimi i atakuar i është dërguar Paditësi më 9 qershor 2010. Kjo do të thotë se periudha prej 30 ditësh ka përfunduar më 9 korrik 2010. Ankesa është ushtruar pikërisht këtë ditë, por i është adresuar Gjykatës Supreme të Kosovës, që është gjykatë që duhet të dallohet qartë nga DHPGJS-ja, që ekskluzivisht merret me çështje që kanë të bëjnë me privatizimin. Veçanërisht, DHPGJS-ja nuk është pjesë e Gjykatës Supreme të Kosovës, por është krejtësisht entitet i veçantë. Gjykata Supreme e Kosovës ka dërguar pastaj ankesën në DHPGJS, ku është pranuar më 14 korrik 2010.

Është përgjegjësi e palës që të adresojë parashtresat në gjykatën kompetente (krahaso Nenin 113 [1] të LPK-së). Nëse një parashtresë e lidhur me afat i adresohet një gjykatë jokompetente (edhe nëse është postuar në kohë), ajo përshkon në rrezik të palës (krahaso Nenin 113 [7] të LPK-së). Nëse përfundimisht arrin në gjykatën kompetente pasi që afati të ketë skaduar, duhet të konsiderohet si e ushtruar pas afatit.

Ky është rasti i tillë këtu. Ankesa pra ishte ushtruar shumë vonë (shih ASC-09-0096, ASC-10-0012, ASC-09-0021 et al).

Edhe nëse nenit 113 [7] i LPK-së do të konsiderohej të jetë zbatuar saktë në këtë kontekst (përmes nenit 70.3 [a] të UA UNMIK-ut 2008/6), kjo nuk do të ndihmonte Ankuesin: nenit 113 [7] i LPK-së parashikon për dorëzimin e parashtresave që lidhen me afat në gjykatat jokompetente, duke urdhëruar që ato të trajtohen si të parashtruara në kohë, nëse dorëzimi i gabuar është bërë për shkak të "mosdijes apo gabimit të hapur të paraqitësit". Nëse pala përfaqësohen siç duhet nga avokati, prapëserapë, ai/ajo nuk mund të përfitojë nga kjo dispozitë. Avokatët profesional, të certifikuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës duhet të dinë mirë të bëjnë dallimin mes DHPGJS-së dhe Gjykatës Supreme si entite të veçanta ligjore (siç përshkruhet më lartë). Adresimi tek Gjykata Supreme në vend të DHPGJS-së shkon më shumë se përtej pavëmendjes, nëse bëhet nga një avokat. Për të njëjtat arsyet, një kërkesë përkthim në gjendjen e mëparshme (neni 117 i LPK-së) nuk mund të jetë i suksesshëm, kështu që Kolegji i Ankesave nuk ka nevojë t'ia bëjë të ditur këtë mundësi Ankuesit para se të vendoset për lëndën.

Si rezultat i kësaj, ankesa e pasafatshme duhet të hedhet poshtë si e papranueshme, pa u marrë me meritat e saj. Prandaj çështjet e mëposhtme mund të mbisin pa përgjigje, por mund të trajtohen nga Trupi Gjykuar në rast se vjen prapë një gjendje e ngjashme: Afati kohor e parashtresës së paditësit më 19 shkurt 2010, përgjigja në urdhrit e datës 30 dhjetor 2009 (dërguar atij më 16 janar 2010), çështja për të sqaruar nëse faktikisht Paditësi kishte ndërmend të përmendte Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP-në) si të Paditur të dytë, apo vetëm si përfaqësuese të të Paditurit të parë, pyetja nëse Paditësi në heshtje ka miratuar veprimet e përfaqësuesit të tij në rast se autorizimi ligjor nuk është konsideruar i mjaftueshëm, duke iu përgjigjur direkt urdhrit për të plotësuar padinë e parashtruar më parë nga avokati, dhe pyetja se në çfarë mase mund të jetë i vlefshëm urdhri për të parashtruar përkthimet në gjuhën angleze nëse nuk e ka këshilluar palën për mundësinë që të kërkojë ndihmë në përkthim (neni 25.8 i UA UNMIK-ut 2008/4). Së fundmi, duhet të kujtojmë praktikën gjyqësore të Kolegjit të Ankesave (shih ASC-09-0072 et al) lidhur me mungesën e adresave për dërgim:

"Neni 27.2 (c) i UA UNMIK-ut 2008/6 parashesh deklarimin e adresës për dërgim e padisë së palës së Paditur në padi. Sipas nenit 28.2 (f) të UA UNMIK-ut 2008/6, në lidhje me nenin 28.4 leg cit, mosparaqitja e adresës do të rezultojë në një urdhër për plotësim apo

korrigjim të padisë brenda periudhës së paraparë, dhe në hedhje poshtë të padisë si të papranueshme nëse urdhri nuk përbushet me kohë. ... Duhet të shënohet në atë rast, se nëse Paditësi pohon se adresa e të Paditurit është e njohur mirë, pa e paraqitur atë, do të ishte e këshillueshme që të kërkohet adresa (sic është bërë këtu nga Trupi Gjykues); megjithatë, hedhja poshtë (përfundimtare) e padisë si e papranueshme do të kërkonte dështimin e dërgimit në atë adresë të Paditurës. Apo, për të thënë ndryshe: Padia mund të hedhet poshtë si e papranueshme vetëm mbi bazat e nenit 27.2 (c) të UA 2008/6, nëse Paditësi nuk e paraqet fare adresën sipas kërkesës, ose nëse dështon dërgimi në atë adresë e cila pohohet si e njohur."

Pika 2 e aktvendimit të atakuar duhet të eliminohet në rastin e ankesës, pasi që udhëzimet për të ushtruar ankesë duke cituar ligjin, pa ndonjë liri veprimi nga ana e gjykatës, janë që asnjë vendim nuk merret në dispozitiv. Informacionet e tilla jepen në arsyet ligjore ose – më mirë – vetëm t'i bashkëngjitet aktvendimit, por nuk mund të jetë pjesë e tij (shih ASC-09-0075, ASC-09-0108, ASC-10-0023, ASC-10-0036, et al).

Sipas nenit 11 të RREG 2008/4 dhe nenit 66 të UA 2008/6, Trupi Gjykues merr vendim lidhur me shpenzimet e bëra gjatë procedurës gjyqësore në shkallën e parë dhe Kolegji i Ankesave – kur vendos për një lëndë përfundimisht – lidhur me shpenzimet e bëra gjatë procedurave gjyqësore në të dyja shkallët.

Në bazë të nenit 57.2 të UA UNMIK-ut 2008/6 Dhoma e Posaçme ka lëshuar Rregullat Plotësuese Procedurale lidhur me Taksat Gjyqësore. Aty thuhet kështu:

'Neni 10 i Udhëzimit Administrativ Nr. 2008/2 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 27.11.2008, lidhur me "Tarifat e Taksave Gjyqësore" – me specifikimet e mëposhtme – shpallet të jetë i aplikueshëm për procedurat gjyqësore para DHPGJS-së.

Neni 10.9 deri te neni 10.23 janë të aplikueshëm – mutatis mutandis – për procedurën e ankimeve para Trupit Gjykues dhe para Kolegjit të Ankesave.

Si sqarim, neni 10.11 është i aplikueshëm edhe për procedurën që drejton ankimin kundër aktvendimeve të shkallës së dytë të Trupit Gjykues.

(...)

Këto rregulla hyjnë në fuqi më 30 qershori 2010, duke i ndryshuar Rregullat Plotësuese Procedurale lidhur me Taksat Gjyqësore të datës 10 mars 2010.

Ato gjithashtu përfshijnë dhe vlejnë për të gjitha veprimet e DHPGJS-së nga data 1 janar 2010, sipas rastit, dhe vlejnë deri më 31 dhjetor 2010.'

Taksat gjyqësore në të dyja shkallës përbëhen nga, në njëren anë një taksë për ushtrimin e parashtresës(ave), në anën tjetër nga një taksë për lëshimin e (një) aktvendimi(eve).

Sa i përket procedurës së ankesave: Shuma e taksës për ushtrimin e ankesës siç rregullohet me nenin 10.11 të Urdhëresës Administrative të Këshillit Gjyqësor të Kosovës Nr. 2008/2 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore ("ADJ") është 30,-- Euro.

Neni 10.15 ADJ përcakton se për aktvendimet për hedhjen e padive (si të papranueshme) duhet të paguhet vetëm gjysma e taksës të rregulluar në nenin 10.1 ADJ (që parimisht i bazon taksat gjyqësore në vlerën e padisë), deri në shumën maksimale prej 30,-- Euro. Kjo vlen edhe për aktvendimet në shkallën e dytë (neni 10.21 ADJ i referohet neneve 10.12 deri 10.18 ADJ). Neni 10.15 në lidhje me nenin 10.21 përfshin aktvendimet në shkallën e dytë që hedhin poshtë ankesat si të papranueshme, si dhe aktvendimet mbi ankesat kundër aktvendimeve të shkallës së parë që nuk i prekin meritat e lëndës.

Përveç kur vlera e padisë dëshmohet të jetë më e vogël (në shkallën e parë nga Paditësi, në shkallën e dytë nga Ankuesi), sipas nenit 10.1 në lidhje me nenit 10.15 dhe 10.21, taksa gjyqësore është 30,-- Euro.

Në lëndën në fjalë, vlera e padisë është 3,905.04 EUR. Prandaj, taksa gjyqësore për aktvendimin në shkallën e dytë është përcaktuar 12.50 Euro.

Siç u theksua më lartë, e njëjta vlen për aktvendimet e shkallës së parë (aktvendimi i atakuar ende nuk ka ngarkuar taksa gjyqësore).

Në përgjithësi, për procedurat e ankimeve vlejnë taksat gjyqësore në vijim:

Tarifat e taksave gjyqësore, neni 10.15 lidhur me 10.1 (aktvendimi në shkallën e parë)	12.50 Euro
Tarifat e taksave gjyqësore, neni 10.11 (ushtrimi i ankesës)	30 Euro
Tarifat e taksave gjyqësore, neni 10.15 lidhur me 10.21 dhe 10.1 (aktvendimi në shkallën e dytë)	12.50 Euro
Gjithsej	55 Euro

Taksat gjyqësore do të barten nga Ankuesi.

Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues i EULEX-it (Nënshkruar)

Torsten Koschinka, Gjyqtar i EULEX-it (Nënshkruar)

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar (Nënshkruar)

Tobias Lapke, Regjistrues i EULEX-it (Nënshkruar)